

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 709 Prot.

Tiranë, më 22.05 2017

VENDIM Nr. 103, datë 17.05.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.8, datë 17.05.2017, pasi shqyrtoi kërkesën për fillimin e zbatimit të punimeve të projektit "*Ndërtimi i Shkollës 9 vjeçare Marie Kaçulini*", në zonën arkeologjike "*B*" Durrës, subjekti Bashkia Durrës, në objektin që zhvillohet mbi gjurmën e objektit të mëparshëm ekzistues. Për zonën tjetër subjekti i licencuar në arkeologji, i kontraktuar nga Bashkia Durrës, do të paraqesë më parë konceptin e sondazheve arkeologjike për shqyrtim e vendimmarrje në KKA,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën për fillimin e zbatimit të punimeve të projektit "*Ndërtimi i Shkollës 9 vjeçare Marie Kaçulini*", në zonën arkeologjike "*B*" Durrës, subjekti Bashkia Durrës, në objektin që zhvillohet mbi gjurmën e objektit të mëparshëm ekzistues, nën monitorimin e DRKK Durrës dhe ASHA e cila do të verifikojë raportet e terrenit, të depozituar pranë saj nga kjo Drejtori.
2. Për zonën tjetër subjekti i licencuar në arkeologji, i kontraktuar nga Bashkia Durrës, do të paraqesë më parë konceptin e sondazheve arkeologjike për shqyrtim e vendimmarrje në KKA.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

